MEKANIZMAT MIQËSORË NË SHKOLLA PËR RAPORTIMIN E DHUNËS NDAJ FËMIJËVE.

Syri i Vizionit

SWEDEN

Save the Children

MEKANIZMAT MIQËSORË TË SHKOLLAVE PËR RAPORTIMIN E DHUNËS TE FËMIJËT (RAPORT)

Dhjetor, 2017

Përmbajtja

HYRJE..... 2

METODOLOGJIA E PUNËS..... 3

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

TE DALAT NGA FOKUS-GRUPET 7

REKOMANDIMET 11

Hyrje

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në institucione parauniversitare është e garantuar me legjislacion vendor përmes Ligjit për arsimin parauniversitar, por është edhe me ligje ndërkombëtare dhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve, në harmoni me të cilën Kosova e ka legjislacionin e saj duke filluar që nga kushtetuta si akti më i lartë ligjor.

Kosova ka hartuar një bazë të mirë ligjore sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga çfarëdo lloj dhune në shkolla. Përpos ligjit, në Kosovë ekzistojnë edhe udhëzime administrative për krijim të mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkolla, si këshilli drejtues, këshilli i prindërve, këshilli i nxënësve, rregulloret brenda shkollave, si dhe është hartuar edhe një protokoll qeveritar për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucione para-universitare.

Në aspektin ligjor, në Kosovë ka një bazë shumë të mirë të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna në shkolla, mirëpo nevojitet hulumtim i tërthortë se sa janë duke u zbatuar këto në praktikë, çfarë mekanizma funksionalë kemi dhe sa janë miqësorë dhe të besueshëm për fëmijët.

Shkolla është institucion që përfshin të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh dallimet mes tyre, si ato gjinore, etnike, racore, fetare, të aftësisë së kufizuar, gjendjes ekonomike, etj. Ndikimi i procesit edukativo-arsimor në jetën dhe zhvillimin e fëmijëve është jashtëzakonisht i lartë. Përpos familjes, shkollimi ka rol kyç në edukimin, ngritjen e njohurive profesionale për jetë dhe lëndë mësimore, si dhe për mbrojtjen dhe sigurinë fëmijëve gjatë gjithë procesit edukativo-arsimor.

Ambientet e sigurta, të qasshme dhe komode në shkollë janë ndër kushtet e para që fëmijët/nxënësit të kenë mundësinë e mësimit cilësor dhe zhvillimit të shëndetshëm dhe produktiv. Mungesa e ambienteve të qasshme nga dhe të përshtatshme për të gjithë fëmijët, si dhe paraqitja e llojeve të ndryshme të dhunës në shkolla, jo vetëm që ndikojnë negativisht në cilësinë e arsimit, por edhe pengojnë zhvillimin e tyre të shëndetshëm fizik, mental, emocional dhe social.

Në përputhje me rëndësinë themelore që kjo çështje ka mbi zhvillimin e tyre, për të mbrojtur fëmijët nga dhuna kërkohet mobilizim dhe përkushtim i të gjitha institucioneve, duke përfshirë edhe prindërit, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat. Ngërthimi i veprimeve të të gjithë këtyre akterëve është i domosdoshëm për të trajtuar me kompetencë dhe efikasitet çështjet e dhunës, në përputhje me mekanizmat në dispozicion të shkollave.

Metodologjia e punës

Ky hulumtim është realizuar përmes takimeve me fokus grupe në dhjetë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta (Ramiz Sadiku dhe Xhemail Kada në Pejë, Zekeria Rexha dhe Yll Morina në Gjakovë, Haziz Tolaj dhe Ibrahim Fehmiu në Prizren, Selami Hallaqi dhe Thimi Mitko në Gjilan si dhe Ismet Rraci dhe Motrat Qiriazi në Klinë). Në këto shkolla janë krijuar nga tri fokus grupe në secilën shkollë, me fëmijë/nxënës, klasat VI-IX, prindër dhe mësimdhënës, me të cilat janë mbajtur takime. Fokus grupet me fëmijë/nxënës kanë qenë prej 25-40 persona varësisht nga numri i nxënësve që kanë pasur shkollat duke siguruar përfshirje të mjaftueshme në hulumtim.

Përzgjedhja e fëmijëve është bërë në mënyrë rastësore -është përzgjedhur çdo i pesti fëmijë sipas renditjes në ditar ku varësisht prej klasës, starti i numrave ka qenë ndryshe, jo i njëjtë (p.sh. klasa VI/2 numrat 6,11,16,21,26 ose VI/3-8,13,18,23,28,32), por në secilën shkollë janë përfshirë nga dy paralele të klasave VI-të deri IX-të.

Përpos zgjedhjes në këtë mënyrë të fëmijëve nga klasët që nuk kanë qenë të përfshirë në këtë përzgjedhje, në fokus grup kemi ftuar edhe kryetarët e klasëve, në mënyrë që hulumtimi të plotësohet edhe me përshtypjet e tyre.

Përzgjedhja e prindërve për pjesëmarrje në fokus grupe është përcaktuar së bashku me shkollat përkatëse. Një numër prej 15-30 prindër, varësisht prej numrit të nxënësve që kanë pasur shkollat , është përzgjedhur nga secili cikël i klasave, duke filluar që nga klasat e para deri në klasën e nëntë.

Në fokus grupet me mësimdhënës kanë marrur pjesë kryesisht mësimdhënës të klasave VI-IX-të, por ndonjëherë edhe ndonjë mësues klasor - për të parë se si qëndron situata edhe më fëmijët/nxënësit e klasëve më të ulëta.

Të gjitha fokus grupet e zhvilluara në shkollat e targetuara janë zhvilluar në koordinim me drejtorët e shkollave, duke respektuar rregullat dhe oraret e shkollave dhe pa penguar mbarëvajtjen e procesit të rregullt mësimor. Sesionet me fokus grupe kanë zgjatur prej 60 deri në 90 minuta, varësisht prej debatit dhe interesimit të pjesëmarrësve në fokus-grupe.

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport është realizuar në kuadër të programit "Detyrimi ynë për të Ardhmen – Mbrojtja e Fëmijëve dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës", i cili implementohet nga organizata Syri i Vizionit (SiV), në partneritet me Save the Children - zyra në Kosovë, mbështetur nga SIDA Suedeze. Ky raport është realizuar nga vetë stafi implementues i programit nga SiV, duke sjellur kështu një pasqyrim të të gjeturave nga fokus grupet e zhvilluara në dhjetë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në pesë komuna. Raporti i hulumtimit pasqyron se çfarë mekanizma miqësorë kanë këto shkolla për fëmijë/nxënës që ata të ndihen të sigurt për të raportuar rastet e të gjitha llojeve të dhunës që ndodhin në shkollë, qoftë dhuna ndërmjet bashkë-moshatarëve, dhuna e mësimdhënësve ndaj fëmijëve /nxënësve dhe anasjelltas, dhuna ndërmjet prindërve dhe mësimdhënësve dhe stafit tjetër që është në shkollë.

Raporti nxjerr në pah që fëmijët/nxënësit janë viktima të dhunës verbale, emocionale, psikologjike e shpesh herë edhe poshtërohen dhe ushtrohet dhunë fizike ndaj tyre nga ana e mësimdhënësve. Këtë gjë e kanë konfirmuar vetë fëmijët /nxënësit e përfshirë në këtë hulumtim, si dhe përfaqësuesit e grupeve të prindërve në disa raste / shkolla. Ka pasur mësimdhënës që janë pajtuar me të dhënat e gjetura në këtë aspekt, meqenëse sipas tyre, ka mësimdhënës që ende përdorin dhunë - nëse jo fizike, atëherë verbale dhe psikologjike.

Mësimdhënësit e përfshirë në këtë hulumtim kanë treguar kryesisht për rastet e dhunës ndërmjet fëmijëve/nxënësve, por edhe për rastet kur ka pasur dhunë të ushtruar nga vetë nxënësit ndaj mësimdhënësve, edhepse këto sipas tyre kanë qenë raste sporadike dhe shumë të rralla, në krahasim me dhunën që fëmijët përjetojnë nga mësimdhënësit. Edhe vetë fëmijët/nxënësit kanë treguar që ka raste të dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, por sipas tyre ato shpesh i përballojnë më lehtë, krahasuar me dhunën që ushtrohet nga stafi pedagogjik dhe/ose mësimdhënësit.

Si mekanizëm të besueshëm dhe miqësor, fëmijët/nxënësit e shohin kutinë e ankesave – sidomos në rast se ajo do të hapej çdo muaj dhe nga një komision i besueshëm. Poashtu, prezenca dhe mbështetja nga një psikolog, sipas fëmijëve/nxënësve, do t'i ndihmonte shumë ata në menaxhimin e duhur të stresit dhe emocioneve që përjetojnë në shkollë dhe familje. Nevojën për psikolog në shkollë e kanë shprehur edhe vetë mësimdhënësit, duke e parë si një mekanizëm që do të ndihmonte shumë në parandalimin e dhunës dhe trajtimin e fëmijëve që mund të paraqesin sjellje të dhunshme në shkollë. Të pakët kanë qenë mësimdhënësit të cilët e shohin psikologun si një mundësi e mirë për të ndihmuar edhe stafin pedagogjik të shkollës, sidomos për mësimdhënësit të cilët ndonjëherë problemet dhe shqetësimet personale dhe/ose kolegiale i shprehin në forma të dhunshme në klasë ndaj fëmijëve/nxënësve.

Sa i përket hapave të raportimit të rasteve të dhunës në shkolla, ky raport nxjerr në pah që fëmijët/nxënësit kryesisht ankohen tek drejtori i shkollës dhe kujdestari i klasës, ndërsa pjesa më e madhe tek prindërit, meqë sipas tyre, aty ndihen më të sigurt. Ndërsa fëmijët/nxënësit që në shkollat e tyre kanë kuti të ankesave, si mekanizëm të parë për t'u ankuar e përdorin atë. Ata kanë treguar raste konkrete ku janë ankuar përmes kutisë dhe janë marrë masa ndaj mësimdhënësve përkatës, gjë që fëmijët/nxënësit e kanë kuptuar me

ndryshimin e sjelljeve të atyre mësimdhënësve ndaj të cilëve janë ankuar. Ky vlerësim (rreth 70%) ka dalë në shkollat Haziz Tolaj dhe Ibrahim Fehmiu në komunën e Prizrenit, ndërsa rreth 50% për shkollat tjera si Zekeria Rexha dhe Yll Morina në Gjakovë, si dhe Ramiz Sadiku në Pejë dhe Selami Hallaqi në Gjilan.

Përmes këtyre fokus grupeve, fëmijët/nxënësit dhe prindërit kanë paraqitur nevojën që menaxhmenti i shkollës të zhvillojë akoma më shumë mekanizma monitorues dhe raportues. Specifikisht, këta mekanizma shihen si të domosdoshëm për të mbrojtur fëmijët/nxënësit nga ndëshkimi apo ashpërsia reaguese e disa mësimdhënësve ndaj të cilëve ka pasur ankesa për sjellje të dhunshme, jo pedagogjike dhe përdorim të një fjalori që nuk përkon me sjelljen profesionale dhe miqësore me fëmijët përgjatë procesit edukativo-arsimor.

Dallimet në qasje dhe favorizimet që disa mësimdhënës bëjnë ndaj disa nxënësve, të cilët vijnë nga familje me ndikim në shoqëri ose mbajnë privilegje të parametrave të ndryshëm. Pothuajse në të gjitha shkollat është hasur një dukuri e tillë, për një numër të mësimdhënësve që bëjnë të tilla dallime, vlerësim ky që ka dalë nga fokus grupet me prindër e që është konfirmuar në disa raste edhe nga vetë fëmijët/nxënësit.

Në shkollat pjesëmarrëse në fokus grupe vërehet që ka rritje të bashkëpunimit në raportin shkollë-nxënës-prindër. Megjithatë, nevoja për një plan konkret për rritjen e këtij bashkëpunimi, sidomos me prindërit, është paraqitur nga vetë prindërit që janë aktivë në shkollë dhe disa mësimdhënës që ishin pjesë e fokus grupeve.Në këtë aspekt, në të gjitha shkollat ku është zhvilluar ky hulumtim, pjesëmarrësit kanë vlerësuar se u mungojnë takimet dhe debatet e përbashkëta. Mësimdhënësit vlerësojnë se takime të tilla do të mund dhe do të duhej të organizoheshin nga vetë shkolla, ku do të mund të diskutohej dhe vlerësohej puna dhe përpjekjet e tyre për parandalimin dhe trajtimin e dukurive që pengojnë zhvillimin e proceseve edukativo-arsimore në të mirë të fëmijëve.

Prindërit në disa shkolla kanë vlerësuar se kanë kufizime për të bashkëpunuar me shkolla, qoftë si këshill i prindërve apo edhe si individë. Si rrjedhojë, ata kanë paraqitur nevojën për ndihmë nga organizatat e shoqërisë civile dhe akterët tjerë jashtë shkollës, në mënyrë që shqetësimet e mundshme ndaj mësimdhënësve të adresohen përmes kanaleve të duhura dhe që fëmijët e tyre të mos pësojnë me masa reaguese ndëshkimore. Në rastet ekzistuese, prindërit vlerësojnë se jo gjithmonë ruhet identiteti i i tyre kur adresojnë shqetësimin lidhur me trajtimin e fëmijës nga ana e shkollës/kujdestares së klasës – sidomos në rast se i tërhiqet vërejtja mësimdhënësit. Sipas tyre, kjo gjë shpesh ndikon që disa prindër të heshtin me të vetmin arsyetim për mbrojtjen e fëmijës nga masat ndëshkimore në aspektin arsimor, të sjelljes, ose të përfshirjes në aktivitete grupore dhe/ose të shkollës. Lidhur me këtë, të njëjtin vlerësim kanë dhënë edhe fëmijët/nxënësit, sipas të cilëve ka pasur raste kur mësimdhënësi ka kërkuar të njoftohet se kush prej tyre ka bërë ankesë për të, qoftë përmes kutisë së ankesave dhe/ose komunikimit me kujdestarin apo drejtorin e shkollës. Madje, ata kanë treguar edhe shembuj kur ata ose bashkëmoshatarët e tyre janë kërcënuar nga mësimdhënësi që ankesat e tyre nuk mund të adresohen për shkak të fuqisë së autoritetit në shkollë, të cilën mësuesit përkatës konsiderojnë se mbajnë karshi fëmijëve/nxënësve.

Në përgjithësi, nëse analizohet diskutimi që është bërë me të tri fokus grupet me fëmijët/nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, mund të thuhet se shkollat çdo vit punojnë shumë e më shumë në parandalimin e dhunës dhe ofrimin e mekanizmave miqësorë për fëmijë. Sipas tyre, ky ndryshim ka ardhur nga angazhimi i organizatave që bashkëpunojnë me këto shkolla dhe vullnetit të menaxhmentit të shkollave dhe disa mësimdhënësve.

Të dalat nga fokus-grupet

Fëmijët/Nxënësit

Në të gjitha shkollat, nga ana e fëmijëve/nxënësve është theksuar se ka dhunë të mësimdhënësve ndaj tyre, kryesisht dhunë verbale, emocionale dhe psikologjike e në disa raste edhe dhunë fizike. Përpos dhunës që përjetojnë nga mësimdhënësit, ata kanë treguar edhe për praninë e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve. Sipas tyre, këto raste të dhunës mes bashkëmoshatarëve vijnë kryesisht nga ngacmimet që lindin përmes mjeteve të komunikimit virtual, sidomos rrjeteve sociale si Facebook dhe Instagram. Sipas fëmijëve/nxënësve, dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve zgjidhet më lehtë, pasiqë në momentin që atë e raportojnë tek kujdestari, drejtori apo në kutinë e ankesave, ndërmerren masa dhe konfliktet adresohen nga këta mekanizma me hapa të shpejtë. Mirëpo, sipas tyre, kjo ndodh vetëm nëse dhuna raportohet. Më së shumti janë brengosëse rastet që nuk raportohen, pasi aty ka mundësi që dhuna nga fëmijët më të mëdhenj ndaj të vegjëlve por edhe bashkëmoshatarëve të zhvillohet në vazhdimësi, ndonjëherë edhe në prani të fëmijëve tjerë dhe krejt klasës.

Në përgjithësi, fëmijët/nxënësit vlerësojnë se e njëjta gjë nuk ndodhë edhe me mësimdhënës, meqenëse trajtimi i këtyre rasteve dallon. Sa i përket informimit rreth funksionimit së mekanizmave për raportim të dhunës, në shkollat Motrat Qiriazi në Klinë, Yll Morina në Gjakovë, Thimi Mitko në Gjilan, Xhemail Kada në Pejë, fëmijët/nxënësit nuk kanë shumë informata rreth funksionalizimit të kutisë, nëse hapet dhe nga kush menaxhohet.

Madje nxënësit e këtyre shkollave kanë kërkuar që këto kuti të funksionalizohen dhe të kenë informata për orarin e hapjes

dhe nga kush hapen që të kërkojnë përgjegjësi nga ta për ankesat apo çështjet që kanë adresuar përmes kutisë.

Fëmijët/nxënësit e shkollave Ibrahim Fehmiu dhe Haziz Tolaj në Prizren kanë shumë informata për kutinë e ankesave, ndihen më të sigurt të raportojnë përmes kutisë dhe njoftohen vazhdimisht për hapjen e kutisë. Situatë e kënaqshme është vlerësuar edhe nga fëmijët e shkollave Zekeria Rexha në Gjakovë, Selami Hallaqi në Gjilan dhe Ramiz Sadiku në Pejë. Megjithatë, sipas tyre, shkolla duhet t'i njoftojë akoma më shumë nxënësit për rëndësinë që ka kutia, meqenëse jo të gjithë e dinë rëndësinë që ka ky mekanizëm dhe mundësitë për të raportuar rastet e dhunës ndaj personave që përdorin dhunën - pavarësisht pozitës së tyre në shkollë.

Ajo çfarë i bënë fëmijët të besojnë se janë ndërmarrë masa ndaj mësimdhënësve kur ata janë ankuar me të drejtë është ndryshimi në sjelljet e tyre, qoftë me kërcënimet që u bëjnë fëmijëve duke kërkuar të informohen se kush është ankuar apo në ndryshimin e sjelljeve të tyre. Është e rëndësishme të theksohet se ky vlerësim ka dalë pothuajse në të gjitha shkollat pjesëmarrëse në fokus grupe.

Si mekanizma të besueshëm, fëmijët kryesisht e shohin kutinë e ankesave dhe psikologun. Në disa shkolla është gjetur se psikologun e cilësojnë si një person tek i cili duhet shkohet vetëm nëse ata kanë probleme psikike. Fëmijët e atyre shkollave që kanë krijuar këtë paragjykim kanë kërkuar që shkolla e tyre të mos ketë psikolog, mirëpo person tjetër me funksion këshillimi, të cilin mund ta përcaktojë shkolla dhe i cili do të kishte një zyre ku fëmijët do të mund të shpreheshin lirshëm dhe do të merrnin këshilla dhe udhëzime. që kanë krijuar këtë paragjykim kanë kërkuar që shkolla e tyre të mos ketë psikolog por person tjetër me funksion këshillimi, të cilin mund ta përcaktojë shkolla, i cili do të kishte një zyre dhe fëmijët do të mund të shpreheshin lirshëm dhe do të merrnin këshilla dhe udhëzime.

Fëmijët/nxënësit ankohen edhe tek drejtorët e shkollës dhe kujdestarët/et e klasës, pasi sipas fëmijëve nëse drejtori apo kujdestari ka raporte të mira dhe miqësore më mësimdhënësin/en, në të cilin/cilën ata ankohen nuk ndërmerr masa. Në të tilla raste,fëmijët vlerësojnë se përkundrazi drejtorët e shkollës dhe kujdestarët/et e klasës i arsyetojnë veprimet e tij/saj, madje edhe ju tregojnë mësimdhënësve se cilët fëmijë/nxënës janë ankuar, ndërsa mund të marrin masa vetëm ndaj atyre që nuk kanë raporte të mira dhe miqësore. Ky vlerësim ka dalur edhe në disa shkolla nga fokus grupi me prindër.

Fëmijët/nxënësit në disa raste ankohen edhe për mungesën e bashkëpunimit dhe qasjes mbrojtëse nga drejtorët e shkollës dhe kujdestarët/et e klasës. Sipas fëmijëve, nëse drejtori apo kujdestari/ja ka raporte të mira dhe miqësore me mësimdhënësin që raportohet për përdorim të dhunës, atëherë nuk ndërmirren masa konkrete ndaj tyre. Në të tilla raste, fëmijët vlerësojnë se përkundrazi drejtorët e shkollës dhe kujdestarët/et e klasës i arsyetojnë veprimet e tij/saj, madje edhe ju tregojnë mësimdhënësve se cilët fëmijë/nxënës janë ankuar. Ky vlerësim ka dalë edhe nga fokus grupet me prindër në disa shkolla. Një e dhënë shumë me rëndësi është se fëmijët/nxënësit janë vetëkritikë. Në shumë raste fëmijët kanë treguar edhe për sjelljet e tyre jo të hijshme dhe që nuk përkojnë me etikën e shkollës dhe orës mësimore, si në rastet kur ata tregohen më pak të kujdesshëm për sjelljet e tyre ndaj mësimdhënësve që kanë më shumë konsideratë ndaj fëmijëve, në krahasim më mësimdhënësit tjerë.

Prindërit

Prindërit e pranishëm në fokus grupe në të gjitha shkollat vlerësojnë se ata nuk angazhohen dhe bashkëpunojnë sa duhet më fëmijët e tyre në shtëpi dhe rrjedhimisht, nuk mjafton vetëm angazhimi i shkollës si institucion. Sa i përket rasteve të dhunës në shkolla, ata kanë thënë se shpesh-herë fëmijët e tyre ose bashkëmoshatarët e fëmijëve të tyre përjetojnë dhunë psikologjike nga ana e mësimdhënësve, duke u etiketuar me emra të ndryshëm në bazë të dukjes, mënyrës së komunikimit apo sjelljes. Një qasje e tillë për ta është e papranueshme dhe për të tilla raste kanë paraqitur ankesa në shkollat përkatëse. Për shumicën e rasteve të raportuara, sipas tyre, nuk janë ndërmarrë masa. Madje, ka pasur raste kur fëmija i tyre ka pësuar, qoftë me ndëshkim në notim apo përmes mos-aktivizimit të fëmijës nga ana e mësimdhënësit gjatë orës mësimore.

Rastet kur disa mësimdhënës privilegjojnë nxënës të familjeve dhe individëve me ndikim në shkollë, komunë dhe/ose shoqëri është evidentuar nga shumica e prindërve pjesëmarrës. Për të tilla raste, prindërit kanë treguar se janë ankuar tek drejtori i shkollës dhe/ose kujdestari i klasës. Sipas tyre, në rast se menaxhmenti i shkollës ka pasur raporte të mira dhe miqësore me këta mësimdhënës, atëherë nuk është ndërmarrë ndonjë veprim. Në të tilla raste, përkundrazi mësimdhënësi është njoftuar se prindi i cilit fëmijë është ankuar, gjë që nuk ka mbrojtur identitetin e prindit dhe as të fëmijës.

Ashtu si fëmijët, edhe prindërit vlerësojnë që shkolla patjetër duhet të ketë një psikolog dhe pedagog. Sipas tyre, këto dy funksione do t'u duheshin në shumë raste më shumë mësimdhënësve se sa fëmijëve, duke vlerësuar se problematikat dhe shqetësimet personale disa mësimdhënës i shprehin tek fëmijët e tyre, qoftë përmes mënyrës së komunikimit verbal apo edhe sjelljes.

Në shumicën prej shkollave pjesëmarrëse në fokus grupe, prindërit nuk janë të njoftuar rreth funksionimit të këshillit të prindërve apo për mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të këshilleve përkatëse. Prandaj, është e domosdoshme nevoja për të analizuar se si përzgjedhen prindërit anëtarë në këto këshille dhe nëse procesi i përzgjedhjes së tyre bëhet në përputhje me udhëzimet administrative përkatëse. Poashtu, prindërit në disa shkolla nuk kanë informata rreth funksionimit të këshillit drejtues të shkollës, si dhe rolin dhe përgjegjësinë që kanë këto këshille. Përpos kësaj, prindërit në disa shkolla e shohin tejet të nevojshme që kujdestarët e klasës të kenë takime të rregullta me prindër - së paku çdo dy muaj. Sipas tyre, që nga fillimi i vitit shkollor e deri në fund të vitit kalendarik 2017, ata nuk kanë pasur takime të tilla.

Prindërit vlerësojnë që funksioni dhe angazhimi i psikologut dhe pedagogut në shkolla do të ndihmonte shumë në parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, qoftë nga mësimdhënësit, por edhe ndërmjet vetë fëmijëve/nxënësve dhe prindërve ndaj mësimdhënësve dhe fëmijëve/nxënësve.

Sipas tyre, ka pasur raste, edhe pse shumë të rralla, kur mësimdhënësit sulmohen në formë verbale, psikike e fizike, ndonjëherë nga prindërit.

Mësimdhënësit

Mësimdhënësit kryesisht e theksojnë dhunën që ndodh ndërmjet bashkëmoshatarëve/nxënësve. Sipas tyre, e gjithë kjo dhunë zanafillën e ka nga përdorimi i internetit për komunikim virtual - kryesisht përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram. Poashtu, prej mësimdhënësve vlerësohet se fëmijëve u janë dhënë shumë të drejta, të cilat shpesh keqkuptohen, pasiqë nuk u janë bërë të qarta edhe obligimet që dalin nga ato, e që janë të përfshira edhe në rregulloret që kanë në shkolla.

Mësimdhënësit poashtu vlerësojnë se prindërit nuk janë duke u angazhuar për të bashkëpunuar sa duhet me fëmijët e tyre dhe nuk janë shumë të pranishëm në shkolla - kryesisht në takimet e rregullta që mbajnë kujdestarët e klasave. Sidoqoftë, disa mësimdhënës kanë qenë shumë vetë-kritikë duke vlerësuar se qasja e tyre ndaj fëmijëve nuk është shumë miqësore dhe nganjëherë ju mungon komunikimi i duhur me respekt të ndërsjellë me fëmijë.

Paraqitja e dhunës ndaj fëmijëve nga disa mësimdhënës është pranuar edhe nga vetë mësimdhënësit, edhepse vlerësojnë që ka raste shumë të rralla ose që kanë ndodhur vite më parë. Nga fokus grupet me mësimdhënës kuptohet se disa prej tyre e vlerësojnë si dhunë vetëm dhunën fizike, duke anashkaluar apo mos ditur pasojat dhe dëmin që shkakton dhuna verbale, emocionale e psikologjike. Nisur nga kjo, shohim nevojën që të zhvillohen trajnime apo sesione informuese për mësimdhënës mbi format dhe pasojat e dhunës ndaj fëmijëve, të cilat cënojnë zhvillimin e tyre - pavarësisht shkallës dhe llojit me të cilin paraqiten.

Prezenca e funksionit të psikologut është parë si shumë e nevojshme dhe e rëndësishme për ti ndihmuar mësimdhënësit për të ofruar qasje miqësore ndaj fëmijëve/nxënësve të cilët nuk tregojnë kujdes për sjelljen e

tyre në orë mësimore dhe në shkolla. Këtë vlerësim e kanë pasur rreth 70% e mësimdhënësve. Në anën tjetër, rreth 30% prej tyre e kanë vlerësuar ndryshe nevojën e pranisë së psikologut në shkolla. Sipas tyre, funksioni i psikologut do t'i ndihmonte më shumë vetë ata se si të menaxhojnë emocionet dhe stresin, i cili shpesh herë ndikohet nga dhe buron jashtë shkollës, dhe i cili nuk duhet të transmetohet assesi tek fëmijët gjatë procesit mësimor.

Sa i përket funksionimit të mekanizmave ekzistues, kutia e ankesave shihet si një mekanizëm shumë i rëndësishëm edhe nga mësimdhënësit. Ata vlerësojnë se funksionimi i kutisë së ankesave i ndihmon edhe ata për të shprehur pakënaqësitë apo dhunën që përjetojnë, qoftë nga fëmijët/nxënësit, prindërit e tyre, kolegët apo edhe stafi menaxhues i shkollës.

Megjithatë, mësimdhënësit vlerësojnë se ka nevojë të jepen më shumë përpjekje efektive nga ana e tyre drejt përmirësimit të situatës së mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna në shkolla. Specifikisht, është vlerësuar se mbajtja e orës së kujdestarisë do të rriste bashkëpunimin e shkollës më fëmijë/nxënës dhe prindër, si dhe do të ndikonte në parandalimin e dhunës dhe dukurive tjera me rrezik, sikurse përdorimi i substancave narkotike, drogës dhe alkoholit.

Në këtë aspekt, gjatë fokus grupeve, mësimdhënësit kanë paraqitur nevojën për avokim tek Ministria e Arsimit lidhur kthimin e orës së kujdestarisë dhe futjen e funksionit dhe angazhimin e psikologëve dhe pedagogëve në shkolla.

Mungesa e njohurive të mësimdhënësve për ekzistimin e **Protokollit Qeveritar për Parandalim dhe Referim të Dhunës në Institucionet Para-universitare** është një e gjetur shumë me rëndësi e këtij hulumtimi. Lidhur me mungesën e këtij informacioni, është vlerësuar se mungon bashkëpunimi nga menaxhmenti i shkollës dhe drejtorët për tu njoftuar rreth akteve ligjore e nënligjore shtetërore që janë në fuqi.

Përfundimet:

Nga ky hulumtim i realizuar në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të lartpërmendura, del se në shumicën e shkollave fëmijët/nxënësit dhe prindërit nuk kanë informata të mjaftueshme për kutitë e ankesave dhe funksionin e tyre. Janë vetëm tri shkolla që kanë më shumë njohuri për kutinë e ankesave dhe të cilat e vlerësojnë atë si një mekanizëm adekuat, i sigurtë dhe i besueshem për raportim të dhunës në shkolla. Nxënësit dhe prindërit poashtu nuk kanë informata të mjaftueshme për rregulloret e brendshme që kanë shkollat, meqenëse sipas tyre, shkollat nuk i kanë afirmuar sa duhet këto rregullore.

Mësimdhënësit kanë vështirësi për të siguruar përgjegjësinë dhe bashkëpunimin e prindërve për të qenë pjesë e takimeve të rregullta dhe individuale kur ftohen nga shkolla apo kujdestari i klasës. Është vlerësuar se prindërit nuk janë shumë aktivë në bashkëpunimin me fëmijët e tyre dhe në angazhimin e tyre në shkollë. Lidhur me këtë, prindërit në disa shkolla nuk janë në dijeni se kush i përfaqëson ata në këshillin e prindërve në nivel klase dhe shkolle.

Mësimdhënësit dhe disa drejtorë të shkollave nuk kanë shumë informata për ekzistimin e Protokollit Qeveritar për Parandalim dhe Referim të Dhunës në Institucionet Para-Universitare, përmbajtjen dhe funksionin e tij lidhur me mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve nga dhuna në shkolla.

Në përgjithësi, në shumicën e shkollave vlerësohet që ka mungesë të një komunikimi dhe/ose dialogu të brendshëm ndërmjet mësimdhënësve që ka të bëjë me trajtimin e rasteve dhunës dhe çështjeve tjera që janë në interesin e përgjithshëm të shkollave dhe zhvillimit efikas të proceseve edukativo-arsimore.

Rekomandimet:

- Shkollat duhet të rifunksionalizojnë apo t'i vendosin kutitë e ankesave dhe të krijojnë një komision transparent dhe të besueshëm për fëmijët dhe akterët tjerë të shkollës lidhur me trajtimin e rasteve të raportuara;
- Menaxhmenti i shkollave dhe kujdestarët e klasave duhet të mbajnë sesione informuese me fëmijë/nxënës lidhur me rregullat, rregulloret dhe mekanizmat tjerë ekzistues në shkolla;
- Shkollat duhet të kenë një mekanizëm të besueshëm për të garantuar ruajtjen e identitetit të fëmijës/nxënësit apo prindit lidhur me ankesat që raportohen për mësimdhënës apo staf tjetër të shkollës për dhunën dhe sjelljet që nuk përkojnë me institucionin;
- Drejtoritë Komunale tw Arsimit duhet të gjejnë mundësi për përfshirjen e funksionit dhe angazhimit të psikologëve në shkolla.
- Menaxhmeti i shkollave dhe këshillet drejtuese duhet të promovojnë rolin e këshillit drejtues përkatës tek mësimdhënësit, prindërit dhe fëmijët/nxënësit;

- Shkollat duhet të përzgjedhin këshillet drejtuese të prindërve në prezencë të shumicës së prindërve, kur ka kuorum dhe kur të zgjidhet këshilli i prindërve në nivel klase apo shkolle – me publikim të përzgjedhjes në tabelat e njoftimit të shkollës;
- Drejtorët e shkollave duhet të mbajnë të njoftuar stafin pedagogjik përkatës lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, rritjen e cilësisë së arsimit si dhe të drejtën e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje;
- Menaxhmenti i shkollave duhet të bëjë vlerësim të nevojave të stafit pedagogjik dhe stafit tjetër për ngritje të kapaciteteve profesionale duke përfshirë edhe trajnime dhe/ose sesione informuese mbi pasojat e dhunës tek fëmijët, mbi ekzistencën e Protokollit Qeveritar për Parandalim dhe Referim të Dhunës në Institucionet Para-universitare, dhe çështje të ngjashme;
- Menaxhmenti i shkollave duhet të krijojë dhe të ketë në funksion një databazë për rastet e raportuara të dhunës në shkolla me informata të plota dhe të paanshme - pavarësisht funksionit dhe pozitës së personit ndaj të cilit/cilës ngriten dhe/ose raportohen ankesa;

- Shkollat duhet të rrisin bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me Qendrat për Punë Sociale për trajtimin e rasteve të dhunës, sidomos në rastet kur shkolla nuk ka mundësi dhe kapacitete humane e profesionale për të trajtuar ato me efikasitet;
- Mësimdhënësit, menaxhmenti dhe stafi i shkollave duhet të trajnohen në ngritjen e kapaciteteve për komunikim dhe qasje të mirëfilltë dhe miqësore në raport me nxënësit dhe mes tyre.

Syri i Vizionit

Save the Children

SWEDEN

"Ky material/botim është financuar nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij materiali e mban plotësisht hartuesi. Qeveria e Suedisë nuk ndan medoemos pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë botim."